

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8321  
E martë, 16 qershor 2026  
Çmimi 0.50 €

Ish-ministri britanik:  
Nuk ka asnjë dëshmi  
bindëse që mund  
ta dënojë Thaçin FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AGK-ja: SULMET ONLINE, KËRCËNIMI KRYESOR PËR SIGURINË E GAZETARËVE FAQE 4-5



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka paraqitur raportin mbi gjetjet kryesore të lirisë së medias, sigurisë së gazetarëve dhe gjuhës së urrejtjes në Kosovë. Sipas këtij raporti, gaze-

tarët vazhdojnë të përballen me sulme, kërcënime dhe presione, veçanërisht në hapësirën digjitale. Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, ka thënë se siguria e gazetarëve vazhdon të cenohet në forma të

ndryshme, veçanërisht në hapësirën online. Ndërsa profesori Jeton Mehmeti ka thënë se gjetja kryesore në këtë raport është normalizimi i komunikimit agresiv dhe stigmatizues ndaj gazetarëve

### OPINION

DEMOKRACIA NUK VARET  
NGA SHUMICA, POR NGA  
INSTITUCIONET QË KUFIZOJNË  
PUSHTETIN E SAJ F. 5

Shkruan:  
Ismet KRYEZIU



### AKTUALE



HUMB JETËN NË NJË AKSIDENT  
TRAFIKU NË ZVICËR DJALI I  
HEROIT JASHAR SALIHU F. 6

KONTINGJENTI "KFOR 8"  
NISËT NGA SHQIPËRIA DREJT  
KOSOVËS F. 3

### EKONOMI



HARADINAJ KRITIKON KURTIN  
PËR ENERJINË: MBI 923 MILIONË  
EURO PËR IMPORTE, ASNJË  
PROJEKT STRATEGJIK F. 8

### SPORT



ADEMI PAS TAKIMIT ME  
INFANTINON: FIFA QËNDRON  
PRANË KOSOVËS F. 11

**GËRVALLA:**  
DO TA PRESIM  
CERTIFIKIMIN E  
REZULTATEVE PARA  
ÇDO DISKUTIMI  
PËR KOALICIONE F. 3

**NJË MUJ  
PARABURGIM  
PËR PESË TË  
ARRESTUARIT  
PËR MASAKRËN  
E REÇAKUT F. 3**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mok: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVË  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# SHBA-ja DHE IRANI ARRIJNË MARRËVESHJE PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS, NËNŠHKRIMI ZYRTAR TË PREMTEN NË ZVICËR

WASHINGTON, 15 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Irani kanë arritur memorandum mirëkuptimi për përfundimin e luftës, duke hapur rrugën për një proces diplomatik që synon normalizimin e marrëdhënieve dhe rifillimin e negociatave për programin bërthamor iranian, raportuan mediet amerikane. Këshilli Suprem i Sigurisë Kombëtare i Iranit ka konfirmuar se marrëveshja është finalizuar pas disa muajsh negociatash intensive. Sipas deklaratës, të gjitha operacionet ushtarake në frontet e konfliktit, përfshirë Libanin, do të ndërpriten "menjëherë dhe në mënyrë të përhershme" duke filluar nga e diela në mbrëmje. Autoritetet iraniane kanë njoftuar se bllokada detare amerikane ndaj Iranit do të hiqet menjëherë. Bisedimet për



marrëveshje përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse do të nisin pasi palët t'i zbatojnë detyrimet e parashikuara në kuadrin fillestar. Memorandumi pritet të nënshkruhet zyrtarisht më 19 qershor në Zvicër dhe do të hapë

një periudhë 60-ditore negociatash mbi programin bërthamor iranian dhe çështje të tjera strategjike. Presidenti amerikan, Donald Trump, e ka cilësuar marrëveshjen arritje historike.

"Kjo marrëveshje e madhe do të sjellë paqe dhe siguri për të gjithë rajonin", ka thënë Trumpi.

Ai ka thënë se ngushtica e Hormuzit do të rihapet pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe se anijet do të mund të kalojnë lirshëm.

Ndërsa ambasadori amerikan Michael Waltz ka lavdëruar presidentin amerikan për rezultatin e negociatave. "Presidenti vendosi interesin e vendit tonë në radhë të parë dhe negocioni një marrëveshje paqeje që do të na mbajë të sigurt dhe do ta pengojë Iranin të sigurojë armë bërthamore", ka shkruar ai në platformën "X".

Ndërmjetësuesit nga Katar, të cilët kanë zhvilluar 17 orë bisedime intensive në Teheran, kanë konfirmuar se palët kanë arritur një marrëveshje. Takime të veçanta përgatitore me secilën palë do të zhvillohen këtë javë në

Doha para ceremonisë zyrtare në Zvicër.

Marrëveshja është mirëpritur edhe nga liderët evropianë. Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar deklaruan se janë të gatshme t'i lehtësojnë sanksionet ndaj Iranit në këmbim të hapave të verifikueshëm për programin e tij bërthamor.

Kancelari gjerman Friedrich Merz ka përshëndetur marrëveshjen si një "përparim diplomatik", duke theksuar se ajo mund të kontribuojë në një Lindje të Mesme më të sigurt dhe në rigjallërimin e ekonomisë globale. Ndërkohë, tregjet kanë reaguar menjëherë. Çmimet e naftës kanë rënë në nivelin më të ulët që nga marsi, ndërsa investitorët kanë vlerësuar se rihapja e ngushticës së Hormuzit do t'i reduktojë rreziqet për furnizimin global me energji.

## MALI I ZI HEDH POSHTË AKUZAT E VUÇIQIT SE ZHVILLON LUFTË HIBRIDE KUNDËR SËRBIË

PODGORICË, 15 QERSHOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi i ka përshkruar si të pabazuara akuzat se Podgorica është duke zhvilluar luftë hibride kundër Serbisë, duke vlerësuar se deklaratat e tilla pasqyrojnë mungesën e gatishmërisë së një pjese të strukturave politike në Beograd për ta pranuar Malin e Zi si shtet sovran. Reagimi ka ardhur pas pretendimeve të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, se Mali i Zi dhe mediet e tij marrin pjesë në veprime hibride kundër Serbisë. Përmes një deklaratë të postuar në platformën "X", ministria malazeze ka vlerësuar se deklaratat e shpeshta nga shteti fqinj dëshmojnë mungesën e gatishmërisë së një pjese të strukturave politike për ta pranuar Malin e Zi si shtet sovran dhe të barabartë, e jo si një hapësirë që duhet t'u rikthehet qendrave të imagjinuara politike. Ajo ka shtuar se deklaratat e tilla zakonisht shtohen sa herë që Mali i Zi bën hapa para në procesin e

anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe kur afrohen zgjedhjet. "Ia lëmë publikut të vlerësojë nëse deklaratat e tilla duhen parë si hyrje në fushatë të reja dezinformimi dhe presionesh politike, apo si përpjekje për ta zhvendosur vëmendjen nga problemet që nuk kanë asnjë lidhje me Malin e Zi", është thënë në deklaratë.

Ministria malazeze ka rikujtuar se vendimi për rikthimin e pavarësisë së Malit të Zi është përfundimtar, demokratik dhe i verifikuar ndërkombëtarisht në referendum, dhe ka shtuar se Mali i Zi dëshiron marrëdhëniet më të mira të mundshme me të gjithë fqinjët, përfshirë Serbinë. Megjithatë, Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi, ka theksuar se marrëdhëniet e tilla mund të ndërtohen vetëm mbi bazën e respektit të ndërsjellë dhe pranimit të realitetit, duke i hedhur poshtë pretendimet se Mali i Zi i ka marrë territor kujtdo. Ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë ka thënë se



reagimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi përbën "konfirmim të natyrës hibride të veprimit të qarqeve të caktuara në Mal të Zi ndaj jetës politike në Serbi".

Ministria serbe ka thënë se akuzat e ashpra publike dhe përpjekjet për ta heshtur palën tjetër paraqesin një tentativë për ndikim të papërshtatshëm ndaj Serbisë, duke shtuar se për marrëdhëniet mes dy shteteve do të ishte shumë më e dobishme që të gjitha çështjet e hapura të zgjidhen

përmes dialogut institucional dhe kanaleve diplomatike. "Serbia nuk ka asnjë pretendim ndaj Malit të Zi dhe nuk e vë në dyshim shtetësinë e tij, por përfaqësuesit e saj kanë të drejtë të vënë në dukje dukuritë që cenojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe krijimin e vazhdueshëm të një atmosfere në të cilën Serbia paraqitet si problem dhe si justifikim për dështimet e brendshme politike", është thënë në deklaratë. Beogradi zyrtar ka bërë thirrje për punë të përbashkët mbi çështje

me interes për qytetarët, si: bashkëpunimi ekonomik, lidhjet infrastrukturale dhe forcimi i besimit të ndërsjellë.

Është theksuar, po ashtu, se Serbia do të vazhdojë të ndjekë politika të përgjegjshme ndaj Podgoricës, por se pret të njëjtin nivel respekti dhe vlerësimi edhe nga pala tjetër. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar për televizionin "Prva" të Serbisë se "mediet në Mal të Zi kanë pasur rol të rëndësishëm në revolucionin me ngjyra në Serbi, ndërsa Mali i Zi zhvillon luftë hibride kundër Serbisë".

I pyetur se si e sheh sot situatën në Mal të Zi, Vuçiq ka thënë se kjo është "çështje e tyre (malazeze)", por ka shtuar se "e vetmja gjë për të cilën mund të flasë, është marrëdhënia e Malit të Zi me Serbinë". "Kjo është një luftë e vërtetë hibride. Meqë ata flasin për luftë hibride, ata po zhvillojnë luftë hibride kundër Serbisë dhe të gjithë marrin pjesë në të, ose bëjnë sikur nuk e shohin që marrin pjesë", ka thënë Vuçiqi.

## Zelensky: Në Rusi po bie mbështetja për Putinin

Kiev, 15 qershor - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se pakënaqësia publike në Rusi për presidentin Vladimir Putin do të vazhdojë të rritet përpara zgjedhjeve parlamentare të planifikuara për në shtator. Zelensky ka pretenduar se agjencitë ukrainase të

inteligjencës kanë siguruar dokumente që i shkojnë në tavolinë Putinit, duke shtuar se udhëheqësi rus rrallë merr informacion plotësisht të saktë. Megjithatë, ai ka thënë se këto dokumente lejojnë nxjerrjen e përfundimeve për tendencat e brendshme në Rusi.

"Pakënaqësia e rusëve me Putinin do të vazhdojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe ajo nuk do të ndalet deri në shtator, kur mbahen zgjedhjet parlamentare në Rusi", ka thënë Zelensky. Ai, gjithashtu, ka vënë në dukje se mbështetja për partinë në

pushtet në Rusi, "Rusia e Bashkuar" është duke treguar një "trend të qëndrueshëm rënës". "Ukraina po propozon të negociojë një paqe dinjitoze. Është e qartë se tendencat nuk do të ndryshojnë dhe me kalimin e kohës kjo mund të nënkuptojë se një marrëveshje do të duhet të



arrihet me dikë tjetër nga Rusia, dikë që nuk e mbyll veten nga realiteti", ka thënë Zelensky.

## ISH-MINISTRI BRITANIK: NUK KA ASNJË DËSHMI BINDËSE QË MUND TA DËNOJË THAÇIN

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ish-ministri britanik Denis MacShane, i cili ka shërbyer në qeverinë e kryeministrit Tony Blair, javën e kaluar ka marrë pjesë në konferencën "Urat e Kujtimit", të organizuar nga "Liria ka Emër" dhe KIPRED-i. Me këtë rast, MacShane është fokusuar edhe në gjykimin e Hashim Thaçit në Gjykatën Speciale. Ai e ka quajtur Thaçin një nga arkitektët më të suksesshëm të komunikimit politik të kohës së luftës, i cili ka arritur t'i bindë mediat ndërkombëtare dhe madje edhe sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, që ta refuzonin propagandën shumë më të sofistikuar dhe më të financuar të regjimit serb. Megjithatë, ai ka thënë se Thaçi ka vendosur "vullnetarisht të dorëzohet para Dhomave të Specializuara në Hagë në nëntor të vitit 2020".

Ish-ministri MacShane, i cili ka pasur edhe karrierë si gazetar dhe autor librash, ka akuzuar disa qarqe perëndimore për zhvillimet në Hagë. "Shpresa naive e disa qarqeve perëndimore se udhëheqësit kosovarë mund të viheshin në të njëjtin plan moral e juridik me skuadrat vdekjeprurëse të regjimit të Millosheviqit ka rezultuar një rrugë pa dalje", ka thënë ai.

Por, përkundër meritave të Thaçit, MacShane ka pohuar se "që prej asaj kohe ai vazhdon të mbahet në paraburgim. Deri më sot nuk është paraqitur asnjë dëshmi bindëse apo dëshmi e besueshme që do të mund të çonte në dënimin e tij".

Denis MacShane e ka përfunduar fjalën e tij duke shtuar se "megjithatë, aq shumë është investuar në idenë se gjykatat ndërkombëtare, gjyqtarët, prokurorët dhe



procedurat ligjore mund të sjellin mbyllje plagësh, pajtim dhe harmoni pas konflikteve të përgjakshme, saqë askush nuk

duket i gatshëm të pranojë një të vërtetë të pakëndshme: Kosova rrezikon të mbetet një shtet i cunguar, për aq kohë sa

Bashkimi Evropian vazhdon të tolerojë fiksionin se njohja e saj e plotë si shtet nuk është e domosdoshme".

## MBI 10 MIJË QYTETARË KANË PËRFITUAR NDIHMË JURIDIKE FALAS GJATË VITIT 2025

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Mbi 10 mijë qytetarë kanë përfituar ndihmë juridike falas gjatë vitit 2025 nga Agjencia për Ndhimë Juridike në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Në fokus të kësaj agjencie kanë qenë kategoritë më të cenueshme: viktimat e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, trafikimit të qenieve njerëzore, fëmijët, të miturit, personat e diskriminuar, si dhe të dhunuarit seksualisht gjatë luftës së fundit.

Në hapjen zyrtare të "Javës për Ndhimë Juridike Falas", ministrja në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka thënë se kjo javë ka për qëllim informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre dhe mundësitë që kanë për t'i mbrojtur ato. "Sot po e hapim 'Javën e Ndhimës Juridike Falas' me një qëllim të qartë: të informojmë sa më shumë qytetarë për të drejtat e tyre dhe për mundësinë që kanë për t'i mbrojtur ato. Në këtë mision, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas luan një rol të



pazëvendësueshëm. Përmes zyrave rajonale, mobile dhe bashkëpunimit me organizata partnere, ndihma juridike falas sot është më afër qytetarëve se kurrë më parë. Ajo arrin në komunat tona, komunitetet tona dhe tek njerëzit që shpesh kanë më së shumti nevojë për mbështetje. Arrin te gratë viktime të dhunës, komunitetet joshumicë, përfituesit e ndihmave sociale, pensionistët, nënat vetushqyese. Rezultatet

flasin vetë: gjatë vitit 2025, agjencia ka ofruar ndihmë juridike falas për më shumë se 10 mijë qytetarë", ka thënë Gërvalla. Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit ekzekutiv të Agjencisë për Ndhimë Juridike, Faton Jashari, ka përmendur çfarë është kërkuar më së shumti nga kjo agjenci. "Në zyrat tona nuk kemi vetëm lëndë. Në to hyjnë njerëz: gra që kërkojnë mbrojtje nga dhuna, prindër që nuk dinë si të mbrojnë fëmijët e tyre, të

rinj që përballen për herë të parë me institucionin, persona të diskriminuar, qytetarë që luftojnë për të drejtën në pronë, për pension, për dinjitet. Në atë moment, ndihma juridike falas nuk është vetëm procedurë; është fjala e parë e qartë në një situatë të vështirë dhe hera e parë që qytetari e ndjen se shteti po e dëgjon. Viti 2025 e dëshmoi qartë këtë praktikë, ku agjencia ka siguruar shtrirje të ndihmës juridike falas në të gjithë

territorin e Kosovës, përmes shtatë zyrave rajonale dhe 23 zyrave mobile. Ka ofruar ndihmë juridike falas për 6 mijë e 797 qytetarë. Stafit ynë ka ofruar 6 mijë e 936 shërbime të ndihmës juridike, ndërsa 733 lëndë janë referuar te avokatët për përfaqësim dhe shërbime të mëtejme. Numri i trajtuar në vitin 2025 arrin mbi 10 mijë. Në fokus kanë qenë kategoritë më të cenueshme: viktimat e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, trafikimit të qenieve njerëzore, fëmijët, të miturit, personat e diskriminuar, si dhe të dhunuarit seksualisht gjatë luftës së fundit", ka thënë ai.

Në anën tjetër, zëvendësdrojtresha e Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në OSBE, Tamar Khidasheli, ka thënë se barrierat ligjore e ekonomike po vazhdojnë t'i pengojnë qytetarët që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre, por me ndihmën juridike falas kjo mund të arrihet.

## Kontingjenti "KFOR 8" niset nga Shqipëria drejt Kosovës

TIRANË, 15 QERSHOR - Në ambientet e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut në Poshnjë të Shqipërisë është zhvilluar ceremonia e nisjes së Kontingjentit "KFOR 8" i cili do të dislokohet në Pejë.

Forcat Tokësore të Shqipërisë kanë bërë me dije se efektivet shqiptarë nisin misionin e tyre me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi të lartë, në mbështetje të paqes,

sigurisë dhe stabilitetit në rajon. "Në ambientet e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit 'KFOR 8' drejt Pejës, Kosovë. Me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi të lartë, efektivet e Forcës Tokësore nisin misionin e tyre në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Përkrah aleatëve të NATO-s,

Forca Tokësore vijon të japë kontribut të çmuar në operacionet ndërkombëtare, duke dëshmuar gatishmëri, profesionalizëm dhe standarde të larta operationale", është thënë në njoftim.

Në përfundim të ceremonisë, Forcat Tokësore shqiptare u kanë uruar suksese pjesëtarëve të kontingjentit në misionin e tyre në Kosovë dhe një kthim të sigurt në atdhe.





## AGK-ja: SULMET ONLINE, KËRCËNIMI KRYESOR PËR SIGURINË E GAZETARËVE

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka paraqitur raportin mbi gjetjet kryesore të lirisë së medias, sigurisë së gazetarëve dhe gjuhës së urrejtjes në Kosovë. Sipas këtij raporti, gazetarët vazhdojnë të përballen me sulme, kërcënime dhe presione, veçanërisht në hapësirën digjitale. Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, ka thënë se siguria e gazetarëve vazhdon të cenohet në forma të ndryshme, veçanërisht në hapësirën online. Ndërsa profesori Jeton Mehmeti ka thënë se gjetja kryesore në këtë raport është normalizimi i komunikimit agresiv dhe stigmatizues ndaj gazetarëve

**EPOKA  
ERE****Lirim GECI**

**PRISHTINË, 15 QERSHOR** - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka paraqitur gjetjet kryesore të lirisë së medias, sigurisë së gazetarëve dhe gjuhës së urrejtjes në Kosovë, ku është vlerësuar se gazetarët vazhdojnë të përballen me sulme, kërcënime dhe presione, veçanërisht në hapësirën digjitale.

Në këtë prezantim është ngritur shqetësimi për përkeqësimin e mjedisit për gazetarinë e pavarur. Po ashtu, në këtë prezantim është thënë se sulmet ndaj gazetarëve, gjuha e urrejtjes, polarizimi politik dhe mosfunksionimi efikas i mekanizmave ligjorë janë duke ndikuar negativisht në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Kosovë.

Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, ka thënë se siguria e gazetarëve vazhdon të cenohet në forma të ndryshme,

veçanërisht në hapësirën online. "Siguria e gazetarëve vazhdon të ndodhë në forma të ndryshme, më së shumti në hapësirën online. Gjithashtu, gazetarët vazhdojnë të jenë cak i sulmeve nga politika, nga qeveria dhe nga parti politike dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës kërkon marrjen e masave. Thirrja e vazhdueshme për politikanët dhe për qeverinë është që të ndalin këto sulme dhe gjuhën publike kundër gazetarëve, sepse ata rrezikojnë drejtpërdrejtë sigurinë e gazetarëve", ka thënë Rexha.

Ndërsa kryetari i Komponentit të Drejtave të Njeriut në UNMIK dhe përfaqësuesi i Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), Jerome Bouyjou, ka thënë se raportet paraqesin të dhëna të bazuara në dëshmi dhe tregojnë për një mjedis gjithnjë e më pak të favorshëm për gazetarinë e pavarur. "Këto raporte na ofrojnë të dhëna të

bazuara në dëshmi, jo thjesht një interpretim, por të dhëna të bazuara në dëshmi, duke lejuar të masim zhvillimet dhe t'i vendosim ato brenda kontekstit më të gjerë të lirisë së mendimit dhe shprehjes, lirisë së medias dhe zhvillimeve të fundit në Kosovë, rajon e më gjerë. Trendët që të gjithë i dëshmojnë në baza ditore tregojnë se mund të jemi duke lëvizur drejt një mjedisi më pak të favorshëm në Kosovë për shprehjen e lirë dhe gazetarinë e pavarur. Kjo nënvizon nevojën për t'i shtuar përpjekjet dhe për t'u përqendruar në parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm. Është thelbësore që të gjitha palët e interesuara të mbeten vigjilente dhe të përkushtuara për mbrojtjen e këtyre lirive themelore", ka deklaruar Bouyjou.

Ndërsa profesori Jeton Mehmeti, i cili ka paraqitur gjetjet e raportit të monitorimit të gjuhës së urrejtjes, ka thënë se gjetja kryesore është

normalizimi i komunikimit agresiv dhe stigmatizues ndaj gazetarëve. "Gjetja më e madhe ose më kryesore e këtij hulumtimi është se prania e gjuhës së urrejtjes në Kosovë nuk ekziston më aq shumë në nivelin penal, pra ashtu siç specifikohet në Kodin Penal të Kosovës, por më shumë kemi një normalizim të komunikimit agresiv dhe stigmatizues, e për këtë do të ofrojmë disa prej gjetjeve tona", ka thënë ai.

Duke paraqitur rezultatet e hulumtimit, Mehmeti ka thënë se polarizimi politik dominon diskursin e dëmshëm në Kosovë. "Gjetja më e madhe dhe më kryesore është se diskursi i dëmshëm në Kosovë dominohet nga polarizimi politik. Nga këto 138 raste që kemi identifikuar, mbi 40 përqind e tyre kanë të bëjnë me diskurs politik e ideologjik, me kuptimin që aktorët e ndryshëm politikë përdorin shprehje të cilat denigrojnë njëri-tjetrin dhe përdorin shprehje të tilla, sikurse që i kemi identifikuar si shprehje 'tradhtar', 'agent i huaj', 'armik' e kështu me radhë. Pra, fjalë të cilat, në vend se të diskutojnë mbi politika publike, kanë për qëllim të demonizojnë dhe të delegjitimojnë personin tjetër dhe të mos flitet për politika publike", ka thënë Mehmeti, duke shtuar se raporti ka evidentuar edhe shtimin e sulmeve ndaj gazetarëve.

"Gjetja tjetër të cilën e nxjerr raporti ka të bëjë me një gjuhë të shtuar të sulmeve ndaj gazetarëve. Dhe kjo, mbase, është gjetja më e rëndësishme në kuptimin e impaktit që mund të ketë për institucionin e gazetarisë. Aty kemi hasur në shprehje, në diskutime dhe në debate, të cilat u referohen gazetarëve me terma të ndryshëm si 'mercenarë', 'të paguar', 'të sponsorizuar', 'marrin çanta me para' e kështu me radhë. Shprehje këto të cilat, gjatë këtij tremujori që kemi, implikojnë dhe ndihmojnë në forcimin e narrativave të ndryshme që gazetarët duhet të shihen me sy të dyshimtë. Dhe kjo është shumë e rrezikshme për demokracinë sepse, siç e thashë, impakti shkon përtej individit si gazetar, por tek institucioni i gazetarisë", ka thënë ai.

Më tutje, Mehmeti ka thënë se raporti ka evidentuar edhe diskurs të dëmshëm ndaj grave, komuniteteve pakicë dhe grupeve të tjera, si dhe rritje të teorieve konspirative. "Gjetja e tretë ka të bëjë me diskursin e dëmshëm ndaj grave, komuniteteve pakicë dhe grupeve të tjera. Këtu kemi parë shprehje të cilat figurat politike i reduktojnë me identitetin e tyre gjinor. Dhe gjetja e fundit ka të bëjë me rritjen e një mase të madhe të teorieve konspirative dhe përdorimin e inteligjencës artificiale", ka

# DEMOKRACIA NUK VARET NGA SHUMICA, POR NGA INSTITUCIONET QË KUFIZOJNË PUSHTETIN E SAJ



Shkruan: Ismet KRYEZIU

Tri palë zgjedhje brenda një periudhe relativisht të shkurtër kanë dëshmuar se vota, në vetvete, nuk është zgjidhje për çdo krizë politike. Zgjedhjet mund të përcaktojnë fitues dhe humbës, por ato nuk mund të krijojnë vullnet politik aty ku ai mungon. Pa një përkushtim të sinqertë për funksionalitet institucional, kulturë kompromisi dhe respektim të rregullave demokratike, zgjedhjet rrezikojnë të shndërrohen në mekanizëm të përsëritjes së krizave, e jo të zgjidhjes së tyre.

Kërkesa e një subjekti politik për të fituar mbi 60 për qind të votave,

siç ishte rasti i LV-së, mund të jetë një synim legjitim elektoral. Çdo parti synon të sigurojë sa më shumë mbështetje. Megjithatë, kur shumica absolute paraqitet si kusht për formim të institucioneve ose si justifikim me arsyetimin se opozita është jobashkëpunuese, kjo shndërrohet më tepër në një përpjekje për përqendrim të pushtetit.

Përvoja e shteteve të rajonit tregon se përqendrimi i pushtetit në duart e një force të vetme politike, edhe kur buron nga zgjedhje formalisht demokratike, mund të çojë drejt sistemeve hibride, ku zgjedhjet zhvillohen rregullisht, por kontrolli institucional, llogaridhënia dhe konkurrenca politike dobësohen gradualisht.

Përqendrimi i pushtetit është një fenomen që shfaqet në forma të ndryshme dhe që vazhdon të mbetet sfidë për shumicën e vendeve të Ballkanit, edhe pas më shumë se 30 vitesh tranzicion demokratik. Ai nuk manifestohet

përmes ndalimit të zgjedhjeve apo eliminimit formal të pluralizmit politik, por përmes dobësimit gradual të kushteve që e bëjnë demokracinë funksionale. Kur zgjedhjet dhe vota ndikohet nga klientelizmi, nepotizmi, punësimet partiake, ndihmat sociale apo varësia ekonomike e qytetarëve nga pushteti, liria reale e zgjedhjes vihet në pikëpyetje. Në këto rrethana, zgjedhjet vazhdojnë të mbahen, por ato nuk garantojnë domosdoshmërisht që qeveria të jetë shprehje e vullnetit të lirë të qytetarëve. Demokracitë nuk rrenohen gjithmonë nga mungesa e zgjedhjeve, por shpesh nga tendenca për ta përqendruar pushtetin në emër të efikasitetit, stabilitetit apo vullnetit të shumicës. Po aq problematike për funksionimin demokratik mund të jetë edhe një kulturë politike ku opozita e sheh bllokimin institucional si strategji të përhershme veprimi. Prandaj, ekzistenca e procesit zgjedhor dhe e shumë partive

politike nuk mjafton për të dëshmuar se një vend gëzon demokraci të konsoliduar. Një demokraci e tillë shpesh mbetet vetëm një pluralizëm formal. Megjithatë, fakti që zgjedhjet e fundit në Kosovë nuk prodhuan një shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve nuk duhet të interpretohet domosdoshmërisht si dëshmi e një kulture politike thellësisht pluraliste apo si refuzim qytetar ndaj tendencave për përqendrim të pushtetit. Një rol të rëndësishëm luan edhe garantuara për komunitetet joshumicë, e bën shumë më të vështirë krijimin e shumicave të mëdha parlamentare që do t'i mundësonin një partie të vetme kontroll të plotë mbi institucionet. Kjo nuk do të thotë se rreziku i pushtetit të përqendruar është i pamundur në Kosovë.

Megjithatë, sistemi aktual institucional e bën më të vështirë krijimin e një dominimi të pakontestueshëm politik, duke ruajtur një nivel të caktuar pluralizmi dhe ndarjeje të pushtetit. Prandaj, sfida kryesore e demokracisë kosovare nuk është thjesht organizimi i zgjedhjeve, por krijimi i institucioneve të forta, të pavarura dhe funksionale, të cilat garantojnë se pushteti buron nga qytetari dhe mbetet i kufizuar nga ligji. Vlerësimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme nuk mund të reduktohet vetëm në procedurën teknike të votimit. Po aq të rëndësishme janë pavarësia e institucioneve, liria e mediave, konkurrenca reale politike dhe barazia e mundësive ndërmjet subjekteve politike. Në fund, demokracia funksionale nuk varet nga fuqia e shumicës, por nga fuqia e institucioneve për të kufizuar pushtetin e çdo shumice.

## Gërvalla: Do ta presim certifikimin e rezultateve para çdo diskutimi për koalicione

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje dhe partnerët e saj do ta presin certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve para se të hyjnë në diskutime për koalicione dhe për çështjen e zgjedhjes së presidentit apo presidentes së vendit. Ajo ka shprehur optimizëm se vendi nuk do të përballet sërish me bllokada institucionale, duke theksuar se mandati i qytetarëve duhet të respektohet. "Nuk i kemi ende rezultatet përfundimtare të certifikuar. Kur t'i kemi rezultatet e certifikuar do të



shohim se cilat janë mundësitë që na ofrohen. Unë shumë shpresoj dhe jam shumë optimiste që nuk do të ballafaqohemi edhe njëherë

me bllokada të pakuptimta dhe me bllokim të institucioneve të shtetit por, siç e keni parë edhe para zgjedhjeve të fundit, nuk ka qenë në dorën tonë sepse

ofertat kanë qenë më shumë se bujare, mirëpo janë refuzuar. Shpresoj që mandati i fuqishëm që e jep vota e qytetarit këtë herë do të respektohet deri në fund", ka thënë Gërvalla. E pyetur nëse kanë vija të kuqe ndaj ndonjë partie apo me cilat subjekte mund të bashkëpunojnë për çështjen e zgjedhjes së presidentit apo presidentes, Gërvalla ka thënë se aktualisht nuk ka diskutime për koalicione. "Nuk diskutojmë as për vija të kuqe e as për koalicione. Do t'i shohim pasi ta kemi marrë rezultatit përfundimtar e të certifikuar, me qëllim që ta dimë cili është mesazhi i qytetarëve. Nëse ne nuk e dimë mesazhin e qartë të

qytetarëve, atëherë gabojmë shumë", ka thënë ajo. Duke komentuar rezultatit e zgjedhjeve, Gërvalla ka thënë se koalicioni i udhëhequr nga Vetëvendosja ka marrë mbështetje të fuqishme nga qytetarët. "Ne kemi fituar zgjedhjet përsëri jashtëzakonisht bindshëm. Përsëri kemi më shumë vota se të gjitha partitë shqiptare të tjera së bashku. Duhet ta respektojmë faktin që qytetari i Kosovës sillet tek kutia e votimit dhe kjo lë gjurmë. Fakt është që koalicioni ynë përsëri ka rezultat bindës dhe mbështetje të madhe, dhe tani duhet të vazhdojmë punët e mira që kemi nisur", ka thënë Gërvalla.

thënë ai.

Kurse menaxherja e programit në Lëvizjen FOL, Burbuqe Kastrati, ka thënë se siguria e gazetarëve vazhdon të mbetet e brishtë. "Gjetjet kryesore të raportit janë se siguria e gazetarëve në Kosovë vazhdimisht vazhdon të mbetet e brishtë, edhe pse format e kërcënimeve kanë ndryshuar ndër vite. Po flas që në kuadër të këtij raporti kemi bërë edhe një analizë retrospektive, pra përpos periudhës të cilën e kemi pasur janar-maj 2026, kemi shtuar edhe një analizë retrospektive duke marrë parasysh periudhën 2021-2025, ku kemi parë që sulmet, kërcënimet dhe format e tjera të presionit ndaj gazetarëve kanë qenë sigurisht të pranishme, por që krahas këtyre incidenteve, të cilat zakonisht janë tradicionale, çka ka

ndodhur në terren, vitet e fundit e ka karakterizuar rritja e kërcënimeve online. Pra, fushatat online dhe sulmet në hapësirën digjitale janë ato që më së shumti karakterizohen dhe kërcënojnë lirinë e mediave në vend, mbi të gjitha sigurinë e gazetarëve", ka thënë ajo. Kastrati ka thënë se vetëm gjatë pesë muajve të parë të vitit 2026 janë raportuar po aq raste sa gjatë gjithë vitit 2025. "Të dhënat e raportit të ardhura nga institucionet, nga Policia dhe Prokuroria e Shtetit tregojnë që vetëm gjatë pesë muajve të parë të vitit 2026 janë raportuar nëntë sulme fizike dhe jofizike nga gazetaret në Kosovë. Ky është i njëjti numër i rasteve sa është raportuar gjatë tërë vitit 2025. Pra, i njëjti numër në total ka qenë numri i përgjithshëm i raportimeve gjatë vitit 2025, kurse në këtë vit që jemi, pra

2026, tani kemi nëntë raste në total nga periudha janar-maj", ka thënë ajo. Duke folur për zhvillimet ligjore që ndikojnë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, Yll Zekaj ka thënë se problem mbetet zbatimi i ligjit dhe trajtimi i padive SLAPP. "Nuk funksionon as zbatimi i ligjit. Vazhdon të jetë numri i madh i rasteve nëpër gjykata, vazhdojnë të jenë të zgjatura këto procedura, përkundër që Këshilli Gjyqësor ka arritur që, në kuadër të strategjisë për trajtimin e lëndëve të vjetra, por ju thashë gjithashtu se paditë SLAPP duhet të trajtohen me urgjencë. Ajo çka duhet të bëhet, besoj edhe që e kemi ngritur edhe përmes AGK-së në Këshillin Gjyqësor, është që paditë SLAPP duhet të marrin përgjigje me trajtim të hershëm. Të shqyrtohen në fazën e parë dhe jo pastaj të njihet kjo në

fund, që e zgjat shqyrtimin gjyqësor dhe pastaj të vërtetohet që është një padi SLAPP", ka thënë Zekaj. Getoarbë Mulliqi, e cila ka paraqitur gjetjet e Indeksit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve 2025, ka thënë se shqetësimi kryesor lidhet me kushtet në të cilat punojnë mediet në Kosovë. "Në çfarë kushtesh punojnë këto media? A mund të raportojnë këto media pa frikë? A kanë qasje në informata publike? A trajtohen si partnerë në interes publik apo trajtohen si kundërshtarë? A mbrohen kur sulmohen? A respektohen kur kritikojnë? Prej këtu fillon shqetësimi ynë kryesor", ka pyetur ajo. Mulliqi ka thënë se Kosova po largohet nga vendet që kanë shënuar përmirësim në lirinë e medias dhe po afrohet me vende ku mjedisi medial është më i

tensionuar. "Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se Kosova nuk është në fund të rajonit, por as nuk është aty ku do të duhej të ishte. Kosova ka ngelur diku në mes. Ajo që e bën këtë vit raportues veçanërisht shqetësues nuk është vetëm pozicioni në mes, por është drejtimi i lëvizjes. Kosova po largohet nga grupi i vendeve që kanë shënuar më shumë stabilitet apo përmirësim në fushën e lirisë së medias, siç janë Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia. Po afrohet më shumë me një grup vendesh ku mjedisi medial është më i tensionuar, më i polarizuar dhe më i pasigurt, si Serbia, Bosnjë-Hercegovina dhe Shqipëria. Ky është mesazhi më i rëndësishëm i këtij raporti. Problemi nuk është vetëm ku jemi sot, por edhe nga po shkojmë", ka thënë Mulliqi.

## Humbet jetën në një aksident trafiku në Zvicër djali i heroit Jashar Salihu

Prishtinë, 15 qershor - Djali i heroit Jashar Salihu, Blerimi, ka humbur jetën në një aksident trafiku në Zvicër. Lajmi është konfirmuar në rrjete sociale nga familjarët. Në njoftim thuhet se aksidenti ka ndodhur mbrëmjen e kaluar në Zvicër, ku Blerim Salihu ka humbur jetën si pasojë e lëndimeve të marra. "Me pikëllim të madh morëm lajmin e hidhur se mbrëmë, në një aksident komunikacioni në Zvicër, humbi jetën Blerim

Salihu, djali i heroit të kombit, Jashar Salihu", thuhet në njoftimin mortor. Lajmi për vdekjen e Blerimit ka pikëlluar ish-deputetin Xhavit Haliti, i cili ka qenë mik i Jashar Salihut. "I trishtuar nga lajmi për humbjen e jetës së Blerim Jasharit, djalit të mikut dhe bashkëveprimtarit tim, njeriut të madh të çështjes kombëtare, Jashar Salihut. Ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve dhe shokëve të Blerimit. Blerim, u prehsh në

paqe!", ka shkruar Haliti në rrjetet sociale. Edhe veprimtari i çështjes kombëtare, Bardhyl Mahmuti, është shprehur i pikëlluar për ndarjen nga jeta të Blerim Salihut. "Ngushëllime nënës së Blerimit, Nerxhivanes, bashkëshortes Albanës, vëllezërve Taulantit dhe Dardanit, djalit të xhaxhait Isniut dhe gjithë familjes atdhetare Salihu nga Botusha e Gjakovës", ka shkruar Mahmuti në "Facebook".



## KPK-ja KËRKON MBI 11 MILIONË EURO SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2027

Prishtinë, 15 qershor - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka miratuar me 7 vota kërkesën buxhetore për vitin 2027 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2028-2029.

Zëvendëskryesuesi i KPK-së, Dardan Vuniqi, ka paraqitur kërkesën buxhetore për vitin 2027 për këtë institucion. "Për strukturat administrative janë paraparë shtesat për funksionin shtesë, shpenzimet e kujdestarisë për prokurorë dhe staf, të cilat janë imediate. Gjithashtu, janë përfshirë shtesat tranzitore, shtesat për kushtet e tregut të punës, shtesat për performancën, shtesat për punën me orar të papërcaktuar dhe shtesat jashtë orarit, si dhe pagat për 185 pozita të kërkuara për këtë vit. Mjetet e nevojshme në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë kërkuar për të mbuluar shpenzimet për ekspertiza gjyqësore, shpenzimet për avokatë dhe



ndërmjetësues, si dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve, përfshirë këtu objektin 'C' të Pallatit të Drejtësisë, i cili ka qenë në përgjegjësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme që nga viti 2025, ndërsa kjo përgjegjësi tashmë është bartur të Këshilli Prokurorial i Kosovës", ka thënë ai, duke shtuar se këto mjete janë të domosdoshme edhe për investime kapitale. "Mjetet shtesë të kërkuara sipas

kategorive janë kryesisht për mbulimin e projekteve kapitale: ndërtimin e objektit për Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe Prokurorinë e Apelit, ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, si dhe avancimin dhe funksionimin e pajisjeve harduerike dhe softuerike për tërë sistemin prokurorial të Kosovës. Buxheti i aprovuar dhe

numri i stafit në të gjitha kategoritë ekonomike për vitin 2027 është si në vijim: 969 pozita. Pagat dhe shtesat janë 14.598.523 euro, mallrat dhe shërbimet 3.694.759 euro, shpenzimet komunale 299.116 euro, shpenzimet kapitale 2.534.501 euro, ndërsa subvencionet dhe transferet 14.400 euro. Pra, gjithsej buxheti i aprovuar për vitin 2027 është 21.141.298 euro", ka thënë ai.

Më tutje, ai ka thënë se është planifikuar që numri i stafit të rritet nga 969 në 1 150.

"Pagat dhe shtesat për t'u mbuluar janë gjithsej 17.766.133 euro, mallrat dhe shërbimet 4.809.560 euro, shpenzimet komunale 299.116 euro, shpenzimet kapitale, pas ndryshimeve dhe kërkesave për ndërtimin e objekteve të reja, janë 9.395.000 euro, ndërsa subvencionet dhe transferet mbeten të pandryshuara në 14.400 euro. Pra, rrjedhimisht,

numri i stafit të planifikuar është 1.150, që paraqet një rritje prej 181 punonjësish ose 18.68 për qind. Pagat dhe shtesat do të shtohen për 3.167.610 euro ose 21.70 për qind, mallrat dhe shërbimet për 1.114.800 euro, shpenzimet komunale nuk do të ndryshojnë, ndërsa shpenzimet kapitale do të shtohen për 6.860.500 euro. Rrjedhimisht, buxheti i planifikuar për vitin 2027 do të ketë një rritje prej 11.142.911 eurosh krahasuar me atë që është planifikuar deri më tani", ka thënë Vuniqi.

Ndërsa kryesuesi i KPK-së, Arian Gashi, ka përmendur disa investime që janë të domosdoshme për funksionimin e zyrtarëve gjyqësorë, sidomos në Pallatin e Drejtësisë ku, sipas tij, mungojnë klimatizuesit në hapësirat e punës. "Sot kemi kolegë në Pallatin e Drejtësisë që, në këto ditë të nxehta, punojnë në temperatura mbi 30 gradë", ka thënë Gashi.

## USHTARËT E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË TRAJNOHEN BASHKËRISHT PËR REAGIM NDAJ KATASTROFAVE NATYRORE DHE URBANE



PRISHTINË, 15 QERSHOR - Në Qendrën Ndërkombëtare Trajnuese për Kërkim-Shpëtim të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është mbajtur trajnimi "Kërkim-Shpëtim Urban Bazik dhe i Avancuar", me pjesëmarrjen e ushtarakëve nga FSK-ja dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë.

Sipas FSK-së, trajnimi është fokusuar në përgatitjen e pjesëmarrësve për reagim ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu si dhe në zhvillimin e aftësive për operacione kërkim-shpëtimi në mjediset urbane. Gjatë aktivitetit janë trajtuar tema që lidhen me planifikimin operacional, përdorimin e

pajisjeve të specializuara, procedurat e kërkim-shpëtimit dhe ofrimin e ndihmës së parë. FSK-ja ka theksuar se trajnimi përfaqëson "vazhdimësinë e bashkëpunimit bilateral mes Kosovës dhe Shqipërisë", me synim rritjen e kapaciteteve për reagim në situata emergjente dhe forcimin e ndërveprimit ndërmjet dy forcave.

## Kryeprokurorja e Pejës takohet me përfaqësues të Ambasadës së Gjermanisë dhe EULEX-it

Pejë, 15 qershor 2026 - Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturije Vuçetaj, ka pritur në takim përfaqësuesit e Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë dhe përfaqësuesit e misionit të EULEX-it. Gjatë këtij takimi është diskutuar bashkëpunimi i Prokurorisë Themelore në Pejë me aktorët ndërkombëtarë që

veprojnë në Republikën e Kosovës si dhe mbështetja e tyre në forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në çështjet me rëndësi për proceset hetimore që trajton kjo prokurori. Palët kanë vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional dhe shkëmbimit të informatave në përputhje me mandatin dhe

kompetencat përkatëse, me qëllim të rritjes së efikasitetit në trajtimin e rasteve dhe forcimit të sundimit të ligjit. Prokuroria Themelore në Pejë mbetet e përkushtuar për bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe për avancimin e standardeve profesionale në ushtrimin e funksioneve të saj ligjore.



# NJË MUAJ PARABURGIM PËR PESË TË ARRESTUARIT PËR MASAKRËN E REÇAKUT

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ua ka caktuar masën e paraburgimit pesë të arrestuarve të dielën nën dyshimin se kanë marrë pjesë në masakrën e Reçakut. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore, gjyqtari i procedurës paraprake ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve N.P., S.J., B.P., S.M. dhe S.S., duke caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji për secilin. "Gjykata vlerësoj se caktimi i masës së paraburgimit në këtë çështje penale është masë adekuate, pasi ekziston rrezik real që nëse të pandehurit lihen në liri, mund të arratisen me qëllim të fshehjes dhe ikjes nga përgjegjësia penale, po ashtu duke marrë parasysh se të gjithë të pandehurit janë edhe shtetas të Serbisë, ekziston rreziku real që të arratisen lehtë dhe të jenë të pa arritshëm për organet e drejtësisë, me çka do të pa mundësohet sigurimi i prezencës së tyre dhe do të pengohet rrjedha normale e procedurës penale", ka njoftuar Gjykata Themelore e Prishtinës.

Gjykata ka vlerësuar se nëse të pandehurit lihen në liri, ekziston rreziku që ata të ndikojnë në prova dhe në dëshmitarë, andaj konstatoi se masa e paraburgimit tani për tani është e vetmja masë për rrjedhjen e papenguar të procedurës penale në këtë çështje penale.

Të dielën gjatë një operacioni të përbashkët të Prokurorisë

Speciale dhe Policisë së Kosovës, në kuadër të hetimeve për krime lufte në rastin e njohur si "Reçaku II" janë arrestuar pesë persona. Sipas Prokurorisë Speciale, të arrestuarit dyshohen se kanë qenë pjesë e njëjës speciale të policisë serbe që morën pjesë në operacionin e 15 janarit 1999 në Reçak, ku u vranë 42 civilë shqiptarë.

Gjatë operacionit janë realizuar urdhër-kontrolle në disa lokacione, ndërsa një person i gjashtë i dyshuar nuk është gjetur në vendbanimin e tij dhe nuk është arrestuar.

Në një konferencë për medie prokuroria ka bërë me dije se të arrestuarit janë të nacionalitetit serb dhe ish-pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Katër prej tyre janë pensionistë, ndërsa njëri vazhdon të punojë në shërbimet postare në Serbi. Sipas Policisë së Kosovës, një nga të dyshuarit është arrestuar në pikëkalimin kufitar në Dheu i Bardhë në orët e para të mëngjesit, ndërsa katër të tjerët në lokacione të ndryshme në Kosovë. Gjatë kontrolleve, autoritetet thanë se kanë sekuestruar dokumente, uniforma, pajisje policore dhe materiale të tjera që konsiderohen relevante për hetimin.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka përgëzuar Policinë e Kosovës, prokurorinë dhe AKI-në për akcionin, duke shkruar në "Facebook" se krimet e luftës nuk do të mbeten pa ndëshkim dhe se ndjekja e përgjegjësve do të vazhdojë pa kompromis. Aksioni ka nxitur edhe



reagimin e Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e pushtetit në Beograd, e cila tha se bëhet fjalë për një "valë të re të frikësimit dhe përndjekjes së serbëve në Shtërpçë dhe Gjilan përmes arrestimeve të pabazuara", me qëllim të "krijimit të një atmosfere frike, pasigurie dhe presioni shtesë ndaj popullit serb". "Ajo që po shohim është dhunë e pastër institucionale dhe presion i motivuar politik ndaj popullit serb. Prishtina tash e disa vjet, përmes veprimeve të tilla, ka tentuar të ndërtojë një narrativë të rrezikshme, sipas së cilës, çdo serb që ka qenë në moshë madhore në vitin 1999 mund të akuzohet pa asnjë bazë për veprat më të rënda penale", është thënë në reagimin e Listës Serbe.

Së voni, autoritetet e Kosovës kanë arrestuar të dyshuar të shumtë dhe kanë ngritur një sërë aktakuzash për krime lufte

në Kosovë. Ndërsa që nga përfundimi i luftës, dhjetëra të dyshuar janë dënuar për këto krime para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Fillimisht pas luftës, përkatësisht nga viti 2000 dhe 2008, krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008, nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). Më 2018 EULEX-i ia ka dorëzuar lëndët organeve vendore të drejtësisë. Më herët, lidhur me rastin "Reçaku II", Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë në mungesë ndaj 21 personave të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile.

Prokurori special Ilir Morina ka thënë se hetimet kanë vazhduar edhe pas ngritjes së aktakuzës në mungesë ndaj 21 personave në dhjetor të vitit të kaluar dhe se gjatë gjashtë muajve të fundit janë siguruar

prova të reja që kanë mundësuar identifikimin e të arrestuarve. Sipas tij, identifikimi i të dyshuarve është bërë përmes videoincizimeve dhe provave të tjera të siguruara gjatë hetimit, përfshirë materiale të publikuara më herët nga mediat në Kosovë dhe Serbi. Morina ka thënë se hetimet nuk janë përqendruar vetëm tek ekzekutuesit e krimet, por edhe tek organizatorët dhe urdhërdhënësit e tij.

Gjykimi në mungesë, që Prokuroria Speciale kishte kërkuar për këtë rast pas ngritjes së aktakuzës, mundësohet në Kosovë pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, të bëra më 2022. Megjithatë, gjykime të tilla mund të bëhen vetëm me kushtin që prokuroria dhe gjykata t'i kenë shteruar të gjitha mjetet për ta siguruar praninë e të akuzuarit. Por, ky kod përcakton se personat që gjykohen në mungesë kanë të drejtë për një rigjykim pa kushte, kur të arrestohen.

Kjo masakër ka shtyrë NATO-n t'i niste bombardimet për t'i dhënë fund luftës së viteve 1998-'99 në Kosovë dhe, përfundimisht, pavarësisht të vendit disa vjet pas çlirimit. Gjatë luftës në Kosovë, nga viti 1998 deri në 1999, janë vrarë mbi 13 mijë civilë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur. Më shumë se 1 500 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Qindra shqiptarë të vrarë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi. Trupat e tyre janë bartur nga forcat serbe me qëllim që të fshihen krimet.

# HYSRI SELIMI DËNOHET ME GJASHTË VJET BURGIM PËR SPIUNAZH PËR SERBINË

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar Hysri Selimi me gjashtë vjet burgim për akuzat se kishte spiunuar për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Serbisë, e njohur si BIA, për më shumë se 15 vjet.

Trupi gjykoes i udhëhequr nga gjykatësi Leon Përlaska e ka shpallur Selimin fajtor për spiunazh gjatë një seance të hënën në mëngjes. Selimi, i cili ka qenë i dënuar më parë në Kosovë për pjesëmarrje në organizata terroriste, nuk ishte i pranishëm në sallë gjatë shpalljes së aktgjykimit.

Ai ka mohuar akuzat për spiunazh dhe ishte deklaruar i pafajshëm në seancën fillestare në shtator 2025. Selimi ngarkohej se kishte bashkëpunuar me BIA-n serbe nga nëntori i vitit 2009 e deri në kohën e arrestimit më 6 maj

2025.

Ai kishte "udhëtuar në Siri, duke iu bashkuar organizatës terroriste ISIS" në fund të vitit 2015.

Selimi ngarkohej se u kishte dërguar të dhëna zyrtarëve të BIA-së në lidhje me numrin e pjesëmarrjes së shqiptarëve në Shtetin Islamik (IS), organizimin e tyre dhe në cilat pjesë të Sirisë operonin ata. "Ndërsa pas kthimit në Kosovë, dhe vuajtjes së burgut për pjesëmarrje në organizata terroriste, i njëjti kishte vazhduar të takohej në Serbi me zyrtarët e BIA-së, më konkretisht me drejtorin për Luftimin e Terrorizmit I.B., dhe të përcjellë të dhëna të tjera të rëndësishme", është thënë në aktakuzë. Ai ishte paguar nga BIA serbe deri në 700 euro në muaj për bartjen e të dhënave, sipas aktakuzës.

Selimi është akuzuar se përmes



veprimeve të tij e rrezikoi dhe dëmtoi rëndë rendin juridik kushtetues dhe sigurinë e Kosovës, duke e ndihmuar po ashtu BIA-n serbe të krijojë një narrativë të dëmshme për shtetësinë e Kosovës.

Së voni, autoritetet në Kosovë kanë arrestuar, akuzuar e

gjykuar serbë e shqiptarë nën dyshimet se po spiunonin për shërbimet e inteligjencës së Serbisë.

Në prill gjykata në Prishtinë e kishte dënuar me gjashtë vjet burgim Jellena Gjukanoviçin, punonjës të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në

Evropë (OSBE).

Gjukanoviçi ishte dënuar për bartjen e të dhënave tek BIA serbe, akuzat se cilat i kishte mohuar. Në Kosovë spiunazhi përkufizohet si aktivitetet sekret i mbledhjes, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit të ndjeshëm në një shtet, organizatë ose grup tjetër. Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me të paktën pesë vjet burgim, nëse i dyshuari shpallet fajtor. Ekspertët kanë thënë se spiunazhi është kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës dhe arrestimet e fundit vetëm sa nxjerrin në pah rrezikun e vazhdueshëm. Sipas tyre, ky aktivitet jo vetëm që destabilizon vendin brendapërbrenda, por dëmton edhe pozitën e tij ndërkombëtare.

## AKB-ja: RITJE NË LETRA E VARFËRI NË JETË, QYTETARËT DHE BIZNESET NUK JETOJNË ME STATISTIKA

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësimin e saj për gjendjen ekonomike në Kosovë dhe për hendekun gjithnjë e më të madh ndërmjet statistikave zyrtare dhe realitetit që po përjetojnë qytetarët dhe bizneset. Sipas AKB-së, nëse rritja ekonomike paraqitet vetëm përmes shifrave në raporte, ndërsa qytetarët përballen me rritje të çmimeve, rënie të fuqisë blerëse dhe vështirësi në përballimin e jetesës, atëherë kjo nuk mund të konsiderohet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik. "Bizneset kosovare po përballen me kosto gjithnjë e më të larta të energjisë elektrike, pagave, lëndëve të para, transportit dhe shërbimeve, duke e bërë më të vështirë ruajtjen e konkurrueshmërisë në treg. Në të njëjtën kohë, konsumi i qytetarëve po ngadalësohet, duke reflektuar sigurinë ekonomike dhe dobësimin e standardit jetësor", është thënë në reagimin e AKB-së.

AKB-ja ka vlerësuar se zhvillimi ekonomik duhet të matet me

mirëqenien e qytetarëve, fuqizimin e sektorit privat, rritjen e eksporteve, investimet produktive dhe hapjen e vendeve të reja të punës, e jo vetëm me tregues statistikorë që nuk reflektohen në jetën e përditshme. "Raportet e institucioneve ndërkombëtare vazhdojnë ta rendisin Kosovën ndër vendet me të ardhurat më të ulëta në Ballkanin Perëndimor, ndërsa inflacioni dhe kostot e jetesës mbeten ndër shqetësimet kryesore të familjeve dhe komunitetit të biznesit", është thënë në reagimin e AKB-së. Në këtë kontekst, AKB-ja ka kërkuar nga institucionet e vendit të fokusohen në politika konkrete ekonomike që mbështesin prodhimin vendor, eksportin, investimet private, uljen e kostove për bizneset dhe rritjen reale të mirëqenies së qytetarëve. "Ekonomia nuk matet me deklarata politike, por me gjendjen financiare të familjeve dhe me aftësinë e bizneseve për të mbijetuar, investuar dhe krijuar vende pune", është thënë



në reagimin e AKB-së. Këto vlerësime janë dhënë gjatë vizitës së afaristit të suksesshëm Shiqeri Emrllahu, i cili vepron në Kosovë dhe Austri në sektorët e

teknologjisë informative dhe ndërtimit. Me këtë rast, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka falënderuar Emrllahu për vizitën, kontributin që po jep në

zhvillimin ekonomik të Kosovës, bisedën konstruktive, angazhimin dhe besimin e vazhdueshëm si anëtar i Aleançës Kosovare të Bizneseve.

## HARADINAJ KRITIKON KURTIN PËR ENERGJINË: MBI 923 MILIONË EURO PËR IMPORTE, ASNJË PROJEKT STRATEGJIK

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ish-kryeministri i Kosovës dhe ish-kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kritikuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, për menaxhimin e sektorit të energjisë, duke e akuzuar për mungesë të investimeve strategjike dhe dështim në realizimin e premtimeve për pavarësi energjetike. Përmes një reagimi publik, Haradinaj ka thënë se qeveria e udhëhequr nga Kurti kishte premtuar transformim energjetik, zhvillim ekonomik dhe zvogëlim të varësisë nga importi i energjisë por, sipas tij, pas më shumë se pesë vjetësh në pushtet, rezultatet mungojnë. "Albin, kur nuk ke rezultate, flet për të kaluarën. Kur nuk ke projekte, flet për projekte që nuk u realizuan. Kur



nuk ke përgjigje për të tashmen, sulmon ata që kanë marrë vendime para teje. Por qytetarët e Kosovës nuk jetojnë në vitin 2018. Qytetarët jetojnë në vitin 2026. Dhe pas pesë-gjashtë viteve të qeverisjes sate, bilanci

është i qartë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Sipas tij, kur e ka marrë pushtetin, Kurti ka premtuar transformim energjetik, pavarësi energjetike nga importi, zhvillim ekonomik dhe investime strategjike. "Sot,

pas pesë-gjashtë vjetësh: Kosova ende nuk e prodhon energjinë që konsumon, pra nuk mund ta mbulojë konsumin; Kosova vazhdon të mbetet importuese neto e energjisë elektrike; Sipas të dhënave të Energy Community, në vitin 2024 Kosova ka prodhuar rreth 6 059 GWh energji elektrike, ndërsa ka konsumuar rreth 6 611 GWh, duke mbetur me deficit prej mbi 550 GWh, kërkesa/ngarkesa kulmore (në peak) në vitin 2025 ka arritur rreth 1 600 MW, ndërsa kapaciteti operativ ka qenë rreth 1 241 MW: Kosova ende mbështetet pothuajse tërësisht në termocentralet me linjit të ndërtuara para më shumë se pesë dekadash; Nuk është ndërtuar asnjë termocentral i ri; Nuk është ndërtuar asnjë central me gaz; Nuk është ndërtuar

asnjë kapacitet i ri bazik prodhues që garanton sigurinë energjetike afatgjate të vendit", ka shkruar ai. Më tutje, Haradinaj ka thënë se në qeverinë Kurti janë shpenzuar mbi 920 milionë euro për blerje të energjisë. "Por le të flasim edhe për faturën që po e paguan Kosova për mungesën e investimeve strategjike. Sipas të dhënave të publikuara për blerjen e energjisë elektrike: Nga 01.01.2015 deri më 31.12.2020 janë shpenzuar mbi 270 milionë euro për blerje të energjisë elektrike. Nga 01.01.2021 deri më 31.03.2026 janë shpenzuar mbi 923 milionë euro për blerje të energjisë elektrike. Pra, gjatë qeverisjes suaj janë shpenzuar mbi 923 milionë euro, ose mbi 652 milionë euro më shumë sesa në periudhën paraprake", ka shkruar Haradinaj.

## Autostrada Shkup - Bllacë drejt realizimit, punimet nisin së shpejti

Shkup, 15 qershor - Ministri i Transportit i Maqedonisë së Veriut, Aleksandar Nikollovski, ka njoftuar se gjatë kësaj vere do të nisë ndërtimi i autostradës Shkup - Bllacë, një projekt i rëndësishëm infrastrukturor që synon përmirësimin e lidhjes me Kosovën dhe rajonin. "Gjatë kësaj vere do të fillojë të ndërtohet autostrada Shkup - Bllacë. Punimet do t'i realizojë konzorciumi i udhëhequr nga

kompania 'Granit', ka deklaruar Nikollovski. Sipas tij, kjo kompani vendore do të jetë bartëse e një projekti madhor i cili pritet të përfundojë brenda tre viteve e gjysmë. "Autostrada Shkup - Bllacë do ta përmirësojë lidhjen me Kosovën dhe Malin e Zi, do të rrisë sigurinë në trafik dhe do të krijojë mundësi të reja për zhvillim ekonomik, tregti dhe investime në rajon", ka theksuar Nikollovski.

Projekti për ndërtimin e kësaj autostrade daton që nga viti 2014. Ndërtimi i segmentit të parë prej 2 kilometrash ka nisur në vitin 2022, ndërsa fillimi i punimeve për segmentin e dytë prej 10 kilometrash ishte paraparë në dhjetor të vitit të kaluar. Zvarritja e punimeve, sipas Ministrisë së Transportit, është shkaktuar nga procedurat burokratike të institucionit financiar.



# FOBITË E FIGURAVE HISTORIKE: NJERËZ TË MËDHENJ QË JETUAN ME FRIKËRA TË PAZAKONTA

Zbuloni fobitë e pazakonta të 7 figurave historike të famshme, nga Napoleoni te Nikolla Tesla. Frikëra që mund të kenë ndikuar në jetën dhe vendimet e tyre.

Nga DG HEWITT

Historia i kujton si pushtues, shkencëtarë, gjeneralë dhe liderë që ndryshuan rrjedhën e botës. Por pas suksesit dhe famës së tyre fshiheshin fobitë e tyre shumë njerëzore. Edhe figurat historike më të mëdha kanë pasur dobësi, ankth dhe fobi që shpesh ndikuan në sjelljen, marrëdhëniet apo vendimet e tyre.

Nga frika e maceve te ankthi ndaj mikrobeve apo hapësirave të mbyllura, këto fobi tregojnë një anë më pak të njohur të njerëzve që lanë gjurmë në histori. Ja disa nga figurat historike më të famshme dhe frikërat e pazakonta që i shoqëruan gjatë jetës.

## Hans Kristian Andersen dhe fobitë se mos varrosej i gjallë

Shkrimtari i mirënjohur danez i përrallave për fëmijë, Hans Kristian Anderson, kishte një imagjinatë të gjallë dhe mendime obsesive se do të varrosej i gjallë. Në fakt frika e tij, ishte jo tërësisht e pabazë. Në epokën viktoriale, raportoheshin qindra raste të njerëzve të varrosur të gjallë, pasi mendoheshin gabimisht se kishin ndërruar jetë.

## Ruzvelt dhe frika nga zjarri

Presidenti amerikan Frenklin Ruzvelt, ishte aq i frikësuar nga zjarri, sa që ushtrohej rregullisht në Shtëpinë e Bardhë, se si të përballonte një situatë emergjente të shkaktuar pikërisht nga zjarri. Kur ishte i vogël ai pa tezen e tij të përfshihej e tmerruar nga flakët, dhe imazhi i syve të saj, do e përndiqte gjithë jetën.

## Hitleri dhe frika nga dentistët

Udhëheqësi nazist gjerman, Adolf Hitler, pëlqente ta portretizonte veten si një supermen. Por ai kishte në fakt shumë frikë dentistët. Kjo shpjegon edhe faktin, se përse Fyhreri kishte një higijenë të tmerrshme orale, sipas vetë dëshmisë së dentistit të tij personal, Johanesh Blashke.

## Salvador Dali dhe fobitë nga insektet

Piktori i famshëm spanjoll, Salvador Dali, ishte i tmerruar nga insektet, dhe kishte një fobi të veçantë ndaj karkalecave. Por



artisti e përdori këtë fobi në dobi të punës së tij. Ai i përdori insektet si motive qendrore në shumë prej pikturave të tij.

## Çezari dhe frika nga bubullimat

Perandori romak, August Çezari, mund të ishte njeriu më i fuqishëm në botë, por ai kishte frikë nga errësira, bubullimat dhe vetëtimat gjatë kohës së keqe. Burimi i fobisë së tij, ishte një rrufe që një ditë goditi për vdekje një skllav, që po ecte shumë pranë tij. Perandori e mori atë si një shenjë se ishte mallkuar nga perënditë. Ai urdhëroi ndërtimin e një tempulli kushtuar Jupiterit, Zotit të Stuhisë. Por kjo nuk do ta pengonte të tmerruhej sa herë që binte shi.

## Pjetri i Madh dhe insektet "e frikshme"

Edhe Cari reformator i Rusisë, Pjetri i Madh, i urrente për vdekje insektet. Shërbëtorët e tij, punonin për orë të tëra për të kontrolluar gjitha dhomat, ku duhej të hynte udhëheqësi. Ato duhej të mos kishin asnjë lloj insekti. Një oficer besnik i

ushtrisë, gjeti vdekjen pasi u godit në kokë nga vetë Pjetri, kur ai zbuloi një kacabu në shtëpinë e tij.

## Mynsh dhe agorafobia akute

Piktori norvegjez Edvard Mynsh, vuante nga agorafobia akute. Frika e tij ndaj hapësirave publike të mëdha, dhe turmave në natyrë u pasqyrua në artin e tij. Sipas disa studiuesve të Mynsh, frika e artistit nga hapësirat e mëdha, mund të ketë qenë rrënjësore në traumën e fëmijërisë. Edvard ishte vetëm 5 vjeç kur e ëma i vdiq nga tuberkulozi. Pastaj, vetëm disa vjet më vonë, motra e tij vdiq nga e njëjta sëmundje. Kjo mund të ketë qenë arsyeja, pse ai ishte aq i frikësuar të dilte jashtë shtëpisë.

## Agorafobia e Marsel Prustit

Ashtu si piktori norvegjez edhe shkrimtari francez, Marsel Prust, vuante nga agorafobia. Megjithatë izolimi nga bota e jashtme, i dha mundësinë që të përqëndrohej në shkrimet e veta. Kryevepra e tij epike "në kërkim të kohës së humbur", është plot 3000 faqe.

## Thomas Xheferson dhe të folurit në publik

Ndërkohë Tomas Xheferson, një nga Etërit Themelues të Shteteve të Bashkuara, vuante nga frika e të folurit në publik. Ai qe një nga autorët kryesorë të Deklaratës së Pavarësisë. Por, ndërsa mund të shkruante me elokucencë mbi një varg çështjesh, tmerruhej kur i kërkoheshin të fliste me zë të lartë në publik, duke u justifikuar në shumë raste se ishte i sëmurë. Megjithatë në fund, Xheferson e mposhti frikën e tij, për t'u bërë një nga amerikanët më të mëdhenj të të gjitha kohërave.

## Alfred Hiçkok dhe fobitë nga vezët dhe pulat

Rregjizori i famshëm britanik i filmave thriller dhe horror, Alfred Hiçkok, ndjente neveri dhe një frikë të madhe ndaj vezëve të pulave. Por ai kishte edhe fobi të tjera, si nga seksi dhe lartësitë. Madje kishte një frikë të përjetshme, se mund të arrestohej gabimisht dhe të burgosej. Kjo e fundit supozohet se daton që në fëmijërinë e tij, kur babai i tij e mbylli në një nga qelitë e policisë lokale, që t'i jepte atij një mësim sa herë që sillje keq.

## Xhengis Kani kishte frikë nga qentë

Udhëheqësi i madh i mongolëve, Xhengis Kan mund të ketë qenë kryekomandanti më i frikshëm i të gjitha kohërave. Por ai ishte i tmerruar nga qentë, edhe pse ndoshta kanifobia e tij ishte e kuptueshme. Qentë në Mongoli, ishin trupmëdhenj dhe aq të egër, dhe mund t'u bënin ballë edhe ujqërve.

## Riçard Nikson dhe fobia ndaj spitaleve

Presidenti amerikan, Riçard Nikson kishte një fobi ndaj spitaleve. Ai kishte frikë se nëse ai do shtrihet për kontroll në njërin prej tyre, nuk do të dilte më gjallë prej andej. Kur u diagnostikua me një koagulim serioz të gjakut pas dorëheqjes së tij, Nikson ishte shumë ngurrues për t'u kontrolluar në spital. Por kirurgët e Shtëpisë së Bardhë e paralajmëruan se nëse nuk shkonte në spital, me siguri që do të vdiste. Në fund, ai u bind të shkonte në spital. Marrë me shkurtime nga "Historycollection" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**

TEL: 045/82 82 82

## Mario Ilievski vazhdon kontratën me Prishtinën

**PRISHTINË, 15 QERSHOR** - Sulmuesi Mario Ilievski e ka vazhduar kontratën deri në vitin 2029 me skuadrën e Prishtinës. Lajmin e ka bërë me dije klubi nga kryeqyteti përmes një postimi në rrjetet sociale.

Ilievski edicionin e fundit

ishte sulmuesi kryesor i Prishtinës. Në të gjitha garat, ai ka realizuar 13 gola dhe ka bërë 5 asistime. Ilievski i është bashkuar Prishtinës verën e kaluar si lojtar i lirë. "Mario Ilievski dhe Prishtina do të vazhdojnë rrugëtimin së bashku deri më 2029.

Sulmuesi më efikas i skuadrës sonë në edicionin e kaluar ka vazhduar bashkëpunimin me klubin, duke mbetur pjesë e bardhekaltërve edhe për tri vjet të tjera. Ilievski aktualisht po vazhdon rikuperimin pas lëndimit të pësuar në fund të sezonit të kaluar, ndërsa të

gjithë në klub i dëshirojmë shërim të shpejtë dhe e presim rikthimin e tij në fushë, për të vazhduar aty ku e la dhe për të udhëhequr repartin ofensiv të FC Prishtinës me gola, asistime dhe paraqitje të rëndësishme", ka njoftuar Prishtina.



## ADEMI PAS TAKIMIT ME INFANTINON: FIFA QËNDRON PRANË KOSOVËS

**MIAMI, 15 QERSHOR** - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka zhvilluar një takim me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, gjatë pjesëmarrjes në Samitin Ekzekutiv të Futbollit të FIFA-s në Miami në kuadër të aktiviteteve për FIFA World Cup 2026.

Ademi i ka cilësuar të shkëlqyera marrëdhëniet e Kosovës me FIFA-n, duke theksuar mbështetjen e vazhdueshme që futbollit i Kosovës ka marrë ndër vite. "Marrëdhënia e shkëlqyer e FIFA-s me Kosovën dhe mbështetja e vazhdueshme për futbollin tonë janë dëshmi e respektit që vendi ynë gëzon në familjen botërore të futbollit", ka deklaruar Ademi. Ai ka vlerësuar afërsinë dhe përkushtimin që, sipas tij,



presidenti Infantino ka treguar ndaj Kosovës dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.

"Vlerësoj lart afërsinë dhe përkushtimin që presidenti Infantino ka treguar vazhdimisht ndaj Kosovës, FFK-

së dhe ndaj meje personalisht", ka thënë ai.

Në kuadër të samitit, ku janë mbledhur drejtues të federatave nga e gjithë bota, diskutimet janë përqendruar te programi FIFA Forward, investimet në

zhvillimin e futbollit dhe krijimi i mundësive të reja për federatat anëtare. Sipas Ademit, vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të rinjve dhe investimeve afatgjata në futboll. "Fokusi i këtij samiti është te programi FIFA Forward, në investimet në zhvillimin e futbollit dhe krijimi i mundësive të reja. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të rinjve si themel i suksesit afatgjatë të çdo federate", ka thënë ai.

Presidenti i FFK-së ka bërë me dije se në ciklin e ardhshëm priten investime të konsiderueshme nga FIFA, të orientuara në infrastrukturë, edukim dhe digitalizim.

"Fondet e planifikuara prej rreth 5 miliardë dollarësh synojnë ta mbështesin infrastrukturën sportive, zhvillimin e projekteve,

avancimin e sistemeve të edukimit dhe digjitalizimit në futboll", ka thënë Ademi.

Më tutje, Ademi ka theksuar përkushtimin e Kosovës për ta vazhduar bashkëpunimin me FIFA-n në funksion të zhvillimit të futbollit dhe investimit në gjeneratat e reja. "Këto investime janë thelbësore për forcimin e federatave në mbarë botën, me theks të veçantë në zhvillimin e vajzave dhe djemve në futboll si dhe në masivizimin e lojës përmes programeve si FIFA Arena, duke krijuar mundësi që sa më shumë fëmijë të përfshihen në sportin më të bukur në botë. Kosova mbetet e përkushtuar që, përmes partneritetit me FIFA-n, të vazhdojë investimin në rini, infrastrukturë dhe të ardhmen e futbollit tonë", është shprehur Ademi.

## VASHAT E KOSOVËS PËRFUNDOJNË GARAT NË EUROPEAN LEAGUE 2026



**Larisa, 15 qershor** - Përfaqësuesja e Kosovës në volejball në konkurrencën e femrave është mposhtur nga Portugalia me rezultat 3:0 në sete (25:13, 25:20, 25:12), në ndeshjen e vlefshme për CEV European League 2026, e zhvilluar në Larisa.

Vashat e Kosovës janë përballur me një kundërshtar cilësor, teksa Portugalia ka dominuar

setin e parë dhe e ka fituar atë me rezultat 25:13. Në setin e dytë Kosova ka zhvilluar lojën e saj më të mirë të takimit, duke qëndruar në garë deri në çastet vendimtare. Megjithatë, portugezët kanë arritur ta mbyllin edhe këtë set në favorin e tyre me rezultat 25:20.

Seti i tretë është karakterizuar nga ritmi i lartë i Portugalisë, e cila ka krijuar epërsi të hershme

dhe e ka menaxhuar atë deri në fund, duke triumfuar 25:12 për ta fituar të gjithë ndeshjen me rezultat të përgjithshëm 3:0.

Kjo ishte ndeshja e fundit e Kosovës në turneun e zhvilluar në Greqi, ku përfaqësuesja e Kosovës ka fituar përvojë të vlefshme ndërkombëtare përballë skuadrave të nivelit të lartë në kuadër të European League 2026.

## Gjiganti turk kontakton Juventusin për Edon Zhegrovën

**TRABZON, 15 QERSHOR** - Trabzonspor i kanë bërë hapat e parë për të nënshkruar me sulmuesin Edon Zhegrova nga Juventus. Ylli i Kosovës është thënë se do të largohet nga "Zonja e Vjetër", me skuadrën italiane që nuk e ka në plane për sezonin e ardhshëm pas një sezoni

zhgënjyes. Zhegrova i është bashkuar Juventusit në ditën e fundit të afatit kalimtar veror 2025, duke nënshkruar në një marrëveshje prej 15 milionë eurove. Sidoqoftë, shkak i lëndimeve të vazhdueshme, Zhegrova nuk ka arritur ta dëshmojë kualitetin, ndërsa skuadra italiane dëshiron ta

largojë sa më parë për të marrë ndonjë lojtar tjetër që i përshtatet Spallettit në atë pozitë.

Sipas "TMW", disa klube turke kanë shprehur interesim për 27-vjeçarin, kurse Trabzonspor i ka ndërmarrë hapat e parë duke kontaktuar zyrtarisht Juventusin lidhur me

Zhegrovën. Negociatat mes palëve ende nuk kanë nisur, por raporti shton se Juve është i gatshëm të negociojë me këdo për kosovarin. Përndryshe, Zhegrova është thënë se ka kërkuar nga Juventus t'ia japë edhe një mundësi për ta dëshmuar kualitetin, kështu nuk po e konsideron fare largimin.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenit 6, nenit 7 paragrafët 3, 4 dhe 5 si dhe nenit 8 të Rregullores Nr.04/2022 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, Rregullores Nr.05/2026 për Klasifikimin e Vendëve të Punës të Administratës në Sistemin Prokurorial, si dhe Vendimit DPSKPK Nr. 259/2026 të datës 12 Qershor 2026, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

**KONKURS Nr. 03/2026**  
**PËR REKRUTIMIN E NJË (1) POZITË PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL**

- Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

**Detyrat dhe Përgjegjësitë**

1. Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
2. Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bën hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin e lëndës detyrën dhe aktet e specializuara për miratim;
4. Mbështetë prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre;
5. Merr pjesë në cilësinë e ekspertit në seanca dëgjimore dhe në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;
6. Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;
7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të institucionit;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Kriteret e Përgjithshme**

Kandidatët për Bashkëpunëtor Profesional në Sistemin Prokurorial duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Të kenë të kryer Provimin e Jurisprudencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- Të kenë së paku një vit (1) përvojë pune profesionale për pozitën që shpallen në Prokuroritë Themelore;
- Të kenë së paku dy vite (2) përvojë pune profesionale për pozitën që shpallen në Prokurorinë Speciale.
- Të kenë së paku tri vite (3) përvojë pune profesionale për pozitën që shpallen në Prokurorinë e Apelit dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Përveç kriterëve të përgjithshme si kriterë plotësuese për vlerësimin e kandidatëve parashihen:

- Të kenë njohuri për Sistemin Prokurorial;
- Të kenë njohuri profesionale në fushën e legjislacionit në fuqi;
- Të kenë njohuri analitike të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;
- Të kenë njohuri për hulumtime ligjore;
- Të kenë njohuri kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, etj).

**Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara<sup>1</sup>;
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën e Provimit të Jurisprudencës, të pranuar sipas Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;

<sup>1</sup> Kandidatët të cilët aplikojnë për bashkëpunëtor profesional duhet të plotësojnë formularin të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkangjitur dokumentet e kërkuara me konkurs.

- Dëshminë mbi përvojën e punës në fushën juridike, të përcaktuar me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
- Certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata;
- Letërnjoftimi.

Kandidatët mund të dorëzojnë edhe dokumentacionet si në vijim:

- Publikime profesionale apo akademike, dhe/ose
- Informata për pjesëmarrje në trajnime.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data **15.06.2026 deri me datë 29.06.2026** si datë e mbylljes së konkursit.

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Sekretariatit të Këshillit në formë fizike, përmes postës ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Stafit Administrativ, kati IV, objekti i Prokurorisë Speciale, rruga "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Kosovë si dhe përmes postes elektronike: [burimet.njerezore@rks-psh.org](mailto:burimet.njerezore@rks-psh.org).

Aplikimi përmes postës: Aplikacionet e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Stafit Administrativ të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", kati i IV, objekti i Prokurorisë Speciale.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, 038/200 66028 prej orës 08:00 – 16:00.

Vetëm kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit dhe që i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet sipas konkursit kanë të drejtë t'i nënshtrohen procesit të rekrutimit. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kriterëve dhe kërkesave të konkursit, nuk do të merren parasysh.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Just Tasty" SH.P.K. pronar Armend Pllana me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811858929 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Just Tasty" D.O.O. Armend Pllana Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811858929 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Just Tasty" L.L.C. with owner Armend Pllana with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811858929 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31. Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, člana 2. stav 3. Zakona Br. 08/L-196 o Platama u Javnom Sektoru, člana 6. člana 7. stavovi 3, 4 i 5. i člana 8. Pravilnika Br. 04/2022 o Postupku Rekrutovanja i Odabira Stručnih Saradnika, Pravilnika Br. 05/2026 o Klasifikaciji Radnih Mesta Administracije u Tužilačkom Sistemu, kao i Odluke ODSTSK Br. 259/2026 od 12 Jun 2026. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje ovaj:

**KONKURS BR. 03/ 2026**  
**ZA REKRUTOVANJE JEDNA POZICIJA STRUČNOG SARADNIKA**

- Osnovno Tužilaštvo Priština, jedna (1) pozicija

**Dužnosti i odgovornosti:**

1. Izrađuje i dobija saglasnost za planove rada i rokove, u koordinaciji sa supervizorom, za implementaciju relevantnih procedura, usluga i relevantnih proizvoda u konkretnoj stručnoj oblasti;
2. Obavlja poslove predviđene odobrenim planom rada u skladu sa zakonom, propisima, politikama i odgovarajućim procedurama, u određenim rokovima;
3. Vršiti pravno istraživanje, analizu, procenu opcija i preporučuje na razmatranje dokumentaciju sa predmetnim rukovodiocem, dužnosti i specijalizovane akte na odobrenje;
4. Podrška tužiocima u vršenju njihove funkcije;
5. Učestvuje kao veštak na ročištima i sudskim ročištima kada se to od njega zahteva;
6. Stara se o očuvanju službene tajne u vezi sa subjektima i informacijama sa kojima se susreće tokom rada.
7. Koordiniše rad sa ostalim jedinicama institucije i komunicira po potrebi i sa spoljnim autoritetima, uvek se brinući za dostojanstveno predstavljanje institucije;
8. Vršiti svaku drugu dužnost iz specifične profesionalne oblasti u skladu sa primenljivim zakonima i pravilnicima koja se od njega može povremeno zatražiti na razuman način.

**Opšti Kriterijumi**

Kandidati za stručnog saradnika u sistemu tužilaštva moraju da ispunjavaju sledeće kriterijume:

- Da su državljani Republike Kosovo;
- Da imaju važeću diplomu Pravnog Fakulteta u Republici Kosovo;
- Da su završili pravosudni ispit priznat u skladu sa zakonom koji se primenjuje u Republici Kosovo;
- **Da imaju najmanje jednu (1) godinu radnog iskustva u struci za radna mesta raspisana u osnovnim tužilaštvima;**
- Da imaju najmanje dve (2) godine radnog iskustva u struci za radna mesta raspisana u Specijalnom Tužilaštvu;
- Da imaju najmanje tri (3) godine radnog iskustva u struci za radna mesta koja su raspisana u Apelacionom Tužilaštvu i Kancelariji Glavnog državnog tužioca.

Pored kriterijuma iz stava 1. ovog člana, kao dodatni kriterijumi za ocenjivanje kandidata predviđa se:

- Poznavanje tužilačkog sistema;
- Posedovanje stručnog znanja iz oblasti važećeg zakonodavstva;
- Posedovanje analitičkog znanja pravnog pisanja i obrazloženja;
- Posedovanje znanja o pravnim istraživanjima;
- Poznavanje rada na računaru u softverskim aplikacijama (Word, Excel itd.).

**Potrebna dokumenta i način prijave**

Kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Popunjenu prijavu sa potrebnim podacima <sup>1</sup>;
- Uverenje o državljanstvu Republike Kosovo;
- Diplomom Pravnog fakulteta koja je važeća u Republici Kosovo;
- Uverenje o položenom pravosudnom ispitu, prihvaćeno u skladu sa zakonom koji se primenjuje u Republici Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu u pravnoj oblasti, definisanoj ovim Pravilnikom i važećim zakonima;
- Uverenje iz kaznene evidencije izdato od suda.

Kandidati mogu dostaviti i sledeća dokumenta:

- Stručne ili akademske publikacije, i/ili
- Informacije o učešću na obukama.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na zvaničnom sajtu Tužilaštva Republike Kosovo, počev od **15.06.2026. do 29.06.2026.** godine kao datum završetka konkursa.

Prijava se zajedno sa pratećom dokumentacijom može dostaviti Sekretarijatu Saveta u fizičkom obliku, poštom ili elektronskom poštom, što se evidentira i svakom kandidatu se dostavlja potvrda o prijemu prijave.

Zahtev (prijava) za prijem u radni odnos dostupan je na sajtu: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org).

Prijave se podnose svakog radnog dana od 8:00 do 16:00 časova, u Divizije za Ljudske Resurse, IV sprat, Specijalno Tužilaštvo Republike Kosovo, ulica „Luan Haradinaj“, 10000 Priština, Kosovo, kao i putem elektronske pošte: [burimet.njerezore@rks-psh.org](mailto:burimet.njerezore@rks-psh.org).

Prijava putem pošte: Popunjeni zahtevi sa dokumentima mogu se dostaviti i poštom Divizije za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Ul. „Luan Haradinaj“, IV sprat, objekat Specijalnog Tužilaštva Republike Kosovo.

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o dostavi učinjene poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i smatraće se, ako stignu u roku od 4 četiri dana, prijave koje pristignu nakon ovog roka, a nepotpune neće biti uopšte razmatran.

U slučaju potrebe možete nas kontaktirati na tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, 038/200 66028 od 08:00 do 16:00 časova.

Samo kandidati koji su se prijavili u roku i dostavili svu dokumentaciju u skladu sa konkursom imaju pravo da učestvuju u procesu regrutacije. Kandidati koji se nisu prijavili u predviđenom roku, kao i oni koji su se prijavili na vreme, ali nisu dostavili kompletnu dokumentaciju u skladu sa kriterijumima i zahtevima konkursa, neće biti uzeti u razmatranje.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- "Ardita" SH.P.K. Shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit me nr. 810232546 të lëshuar nga ARBK.

Ndërmarrja e re Deva Uzina e përpunimit të gazrave teknike sh.p.k. Gjakovë shpall të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810812273 të lëshuar nga ARBK.

- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Flemingo Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. " Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjurar nga Gërqina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.

<sup>1</sup> Kandidati koji konkurišu za stručnog saradnika moraju da popune formular koji se nalazi na linku <https://prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> uz prilaganje dokumenata koji su zatraženi konkursom.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 2 paragrafi 3, nenit 39 paragrafi 15 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, të Rregullores Nr. 03/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, Rregullores Nr. 05/2026 për Klasifikimin e Vendeve të Punës të Administratës në Sistemin Prokurorial, nenit 2, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe në bazë të vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm DPSKPK/Nr. 157/2026 të datës 17 prill 2026, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

**K O N K U R S**  
Nr. 09/2026

|                                      |                                |
|--------------------------------------|--------------------------------|
| <b>I. Titulli i vendit të punës:</b> | <b>Zyrtar Ligjor</b>           |
| Emërtimi i pozitës:                  | Profesional 2                  |
| Grupi, klasa, koeficienti/paga bazë: | P14 5.85                       |
| Institucioni/Njësia:                 | Prokuroria Themelore Prishtinë |
| Numri i pozitave:                    | Një (1) pozitë                 |
| Kohëzgjatja e Emërimit:              | Pa afat                        |
| Periudha provuese:                   | Gjashtë (6) muaj               |
| Afati për aplikim:                   | 15.06.2026 – 29.06.2026.       |

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës:**

- Ndihmon në mënyrë profesionale Prokurorin me daktilografim profesional të akteve që i nxjerrë prokurori lidhur me lëndët konkrete të besuara për ndërmarrjen e veprimeve akuzuese nga prokurori;
- Pranon lëndët e ndara për prokurorin me të cilin punon, evidentimin e tyre në mënyrë elektronike dërgimin e lëndëve me shkresat përcjellëse në shkrimore, mbajtjen e evidencës për lëndët në proces dhe lëndët e kryera, raporton për punën e vet te Udhëheqësi i Administratës;
- Merr pjesë në procesin e dëgjimit të palëve duke e mbajtur procesverbalin e marrjes në pyetje, ruan konfidencialitetin e lëndës dhe palëve;
- Kryen të gjitha punët përgatitore për praninë e palëve para prokurorit me dërgesën e ftesave dhe pranimit e konfirmimeve nga dorëzuesit e shkresave;
- Gjithnjë kujdeset për informimin e Prokurorit lidhur me praninë e tij në gjykime, duke mos e lënë anash informimin lidhur me shkresat e ndryshme apo (corpora deliktet) që ndërlidhen me lëndën gjyqësore;
- Për punën e vet i përgjigjet udhëheqësit të zyrës për Mbështetje Juridike, ndërsa për punën e kryer me prokurorin lidhur me lëndët mbanë edhe përgjegjësi tek prokurori i çështjes, andaj kërkohet një sy çelësi dhe vëmendje e veçantë;
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojës dhe kërkesave të Mbikëqyrësit.

**Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën; kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

**Kriteret specifike shtesë, nëse ka:**

- Nuk ka.

**Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit:**

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- Njohuri të mira të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve.
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analitik.
